



Nr. 67

Viti i gjashtë i botimit

Dhjetor 2018

*Në këtë numër do të gjeni:*


- *Aksione Komunitare në Zonat e Mbrojtura*
- *Procedurat e VNM - Praktikrat e Zbatuara*
- *Njoftim për Shtyp / nga Qendra EDEN*
- *Trainime për OSHC-të nga rajoni / nga Qendra EDEN*
- *Shoqëri pjesëmarrëse në vendimmarrje / nga Qendra EDEN*
- *Si e përmirëson pjesëmarrja publike vendimmarrjen për çështjet mjedisore?*
- *...me këtë rast Ju kujtojmë se...*
- *Njoftime*

### *Aksione Komunitare në Zonat e Mbrojtura*

Nëntor 2018 - Në kuadër të projektit "Aksione Komunitare për Zonat e Mbrojtura- A.C.A.P.", INCA vazhdon fushatën ndërgjegjësuere dhe edukuese e titulluar "Thirrje shkollave për veprim", me mësueset dhe nxënësit e shkollave dhe komunitetin pranë zonave të mbrojtura.

Këtë muaj INCA ka udhëtuar drejt qytetit të Vlorës dhe atij të Beratit ku janë përzgjedhur përkatësisht zonat e Parkut Kombëtar "Llogorai", Peisazhi i Mbrojtur Vjosë-Nartë dhe Parku Kombëtar "Mali i Tomorrit".

Qëllimi i kësaj fushate është të përmirësojë dhe të rrisë ndërgjegjësimin dhe edukimin mjedisor mbi mbrojtjen e zonave të ndjeshme natyrore dhe të inkurajojë perceptimin dhe sjelljen ndaj *Vijon në faqe 2*



*Vijon nga faqe 1* natyrës si dhe të nxisë frymëzimin për aksione me fokus ruajtjen dhe promovimin e natyrës.

Fushata ndërgjegjëse "Thirrje shkollave për veprim", zbatohet nga Instituti për Ruajtjen e Natyrës në Shqipëri (INCA), stafet e AdRZM-ve të Vlorës dhe Beratit në bashkëpunim me organizatën italiane COSV.

Në këtë kuadër u zhvilluan trajnime me mësueset e shkollave 9-vjeçare (mësues të ciklit fillor si dhe mësues të lëndës gjeografi dhe biologji në klasat e

nivelit 5-9) pranë zonave pilote që merren në konsideratë nga ky projekt.

Trajnimit u zhvillua nga ekspertë të IZHA, ekspertë të AKZM, INCA dhe COSV bazuar në modelet e edukimit mbi riciklimin si dhe interpretimin e vlerave të Zonave të Mbrojtura dhe mundësitë për ti shfrytëzuar ato si një laborator i hapur në natyrë në shërbim të kurikulave aktuale mësimore.

Ky projekti mbështetet nga Agjencia Italiane për Bashkëpunim dhe Zhvillim.

*Vijon në faqe 3*




*Vijon nga faqe 2* Gjithashtu në këtë kuadër kanë filluar dhe po vazhdojnë edhe orët e hapura informative në shkollat e zonave pilote si në shkollën "Pilo Prifti" të Novoselës, në shkollën "Balil Pelari" të Orikumit, në shkollat "Nonda Bulka" dhe "Meleq Gosnishti" të Përmetit.

Gjatë këtyre orëve dedikuar mjedisit, me fokus zonat e mbrojtura, mësues dhe specialistë të INCA, përfaqësues të Administratave Rajonale të Zonave të Mbrojtura të Vlorës dhe Gjirokastrës, bashkëbiseduan

me nxënësit mbi natyrën dhe zonat e mbrojtura kurse përfaqësuesit e AdRZM-ve i informuan mbi punën që administratat realizojnë për mbrojtjen dhe menaxhimin e zonave të mbrojtura, veçanërisht zonave që ata kanë pranë.

Po ashtu, nxënësve ju ofrua edhe mundësia e pjesëmarrjes në programin "Junior Ranger", ku ata të marrin pjesë edhe në terren duke vepruar si të ishin ranger të zonave të mbrojtura.



*Vijon në faqe 4*



*Vijon nga faqe 3* Klasa e V-të e shkollës "Nonda Bulka", Përmet së bashku me mesuese Leonora Meraj, zhvilluan dy orë të hapura në natyrë me temë *ndotja dhe prandalimi i mbetjeve si dhe shërbimet turistike dhe mjedisi*.

Gjatë këtyre orëve dedikuar mjedisit, nxënësit u aktivizuan në pastrimin e territorit të ndotur pranë fshatit Dishnicë duke dhënë mesazhin për një menaxhim më të mirë të mbetjeve urbane si dhe për të ndërgjegjësuar sa më shumë banorët dhe fëmijët e zonës për ta mbajtur sa më pastër territorin e tyre.

Një tjetër aktivitet i nxënësve, ishte vizita pranë operatorit turistik Ferma "Grand Albanik", Ballaban, Përmet. Nxënësit intervistuan pronarin dhe menaxherin e fermës me qëllim vlerësimin se sa eko-miqësor me mjedisin ishte aktiviteti që ushtronte ferma. Fëmijet kishin përgatitur më parë në klasë një pyetësor sëbashku me mësuesen dhe në bazë të tij ndërtuan bashkëbisedimin me punonjësit e fermës. Në përfundim të aktiviteteve ata sollën në klasë rrezultatet e mbledhura dhe i analizuan ato të gjithë sëbashku.



## Procedurat e VNM - Praktikrat e zbatuara

**Krujë - 23 Nëntor 2018** - Në kuadër të projektit CO-SEED - "Shoqëria Civile Vepron për Zhvillimin Social Ekonomik mbi Bazat e një Mjedisit të Shëndetshëm", Instituti për Ruajtjen e Natyrës në Shqipëri në bashkëpunim me Qendrën EDEN dhe Milieukontakt Shqipëri organizuan në datë 23.11.2018, vizitën në terren të disa përfaqësuesve të mediave vizive dhe të shkruara, më qëllimin e prezantimit të shembujve të zbatimit të procedurave që përdoren për studimet e VNM-së të projekteve të ndryshme duke përdorur dhe shfrytëzuar burimet natyrore.



Zvogëlimi i burimeve natyrore, humbja e biodiversitetit dhe ndryshimet klimaterike kërcënojnë seriozisht kushtet mjedisore që janë të nevojshme për ekzistencën njerëzore dhe themelet e begatisë sonë ekonomike. Të gjitha këto probleme e kanë zanafillën në përdorimin pa kritere të burimeve natyrore, të cilat mund të rregullohen nëse ne ndjekim parimet e zhvillimit të qëndrueshëm kur planifikojmë përdorimin e tyre.

Në këtë kontekst, projekti i titulluar Shoqëria Civile Vepron për Zhvillimin Social Ekonomik mbi Bazat e një Mjedisit të Shëndetshëm ka si qëllim që të kontribuojë për zhvillimin e qëndrueshëm të burimeve natyrore përmes një kuadri të përmirësuar rregullator dhe proceseve vendimmarrëse me shumë pjesëmarrje dhe më shumë transparente, të cilat përfshijnë një grup aktiv të organizatave të shoqërisë civile dhe një vëmendje në rritje të medias mbi këtë temë, me përfitime për shoqërinë në shkallë të gjerë.

Projekti ka synuar dhe në lidhjen e veprimit të tij me

mediat si një nga aktorët kyç në procesin e transparencës dhe të informimit të publikut mbi planet e projektet e ndryshme në dobi të zhvillimit ekonomik, por në harmoni me natyrën, që të krijohen burime të mjaftueshme natyrore dhe për brezat e ardhshëm.

Nga bashkëpunimi me mediat gjatë gjithë kohës së zbatimit të projektit është evidentuar se Media është e interesuar për procesin e VNM dhe VSM në Shqipëri, posaçërisht për ndikimet që projektet e ndryshme kanë në mjedis, si në natyrë, ashtu edhe në aspektin socio-ekonomik. Mbështetur në shprehjen nga ana e tyre për angazhimin në rastet konkrete të paraqitura përmes gjetjeve dhe vëzhgimit të OSHC-ve që kanë marrë pjesë në konsultime të ndryshme publike ose në vëzhgimin e hapave të procesit të VNM që nga publikimi i studimit deri në procesin e vendimmarrjes në Agjencinë Kombëtare të Mjedisit organizatat INCA, EDEN dhe Milieukontakt iu ofruan përfaqësuesve të mediave informacion rreth studimeve të kryera nga ana e tyre për vëzhgimin e procesit të VNM dhe i ftuan të shihnin në terren ndikimet e identifikuara në studimet e VNM dhe gjithashtu të ndiqnin procesin e monitorimit në masat zbutëse të propozuara në studimet e VNM gjatë zbatimit të projektit. Në këtë vizitë mediate iu prezantuan shembulli pozitiv ku procesi është realizuar



në përputhje me kërkesat ligjore dhe me zbatimin e kërkesave për rehabilitimin dhe zbutjen e ndikimeve negative në mjedis dhe shembulli negativ i moszbatimit të procesit të identifikimit korrekt të ndikimeve në mjedis të shoqëruara dhe me propozime

*Vijon në faqe 6*

Vijon nga faqe 5 jo korrekte të masave zbutëse për të minimizuar ndikimet negative të zbatimit të projektit në mjedis.



Zona e përzgjedhur si shembull negativ për këtë vizitë në terren të mediave është një zonë që është shpallur së fundmi me VKM nr.468 dt.26.07.2018 "Për shpalljen e ekosistemit natyror Kraste -Verjon Peisazh i Mbrojtur" duke i dhënë më shumë vlera natyrës së saj e cila ka pasur një problematikë të vazhdueshme me aktivitetin e gurorëve që janë lejuar të shfrytëzojnë gurët duke prishur pjesën e pyllit që kjo zonë ka pasuri dhe duke ndryshuar peizazhin që ajo ofron. Herë pas here janë bërë kontrolle për mënyrën e shfrytëzimit të kësaj zone, por investitori nuk ka respektuar kërkesat e dhëna në lejen mjedisore dhe për më tepër nuk janë respektuar masat zbutëse që janë propozuar për mënyrën e shfrytëzimit të inerteve



të dhëna në studimin e vlerësimit të ndikimit në mjedis për ndikimet mjedisore që do të kishte projekti. Zona e përzgjedhur si shembull pozitiv është ajo e Priskës ku projekti i shfrytëzimit të inerteve ka zbatuar me korrektësi masat zbutëse rehabilituese të propozuara në studimin e vlerësimit të ndikimit në

mjedis duke u bazuar në specifikat e natyrës që ka zona dhe në përshtatjen e saj sa më afër kushteve natyrore të mëparshme.

Ky aktivitet do të shërbejë për një lidhje edhe më të ngushtë të mediave me organizatat e shoqërisë civile për të prezantuar sa më shumë transparencë dhe informim për mënyrën e zbatimit të procedurave që kuadri ligjor i ka bashkëngjitur procesit të përgatitjes dhe zbatimit të studimeve të vlerësimit të ndikimit në mjedis dhe masave zbutëse që propozohen në këto studime për të minimizuar sa më shumë ndikimet negative në mjedis të projekteve të ndryshme në dobi të zhvillimit të qëndrueshëm ekonomik në harmoni me përdorimin me cilësi të burimeve natyrore.



<https://www.youtube.com/watch?v=gG4Tik8dgnA>

<https://www.youtube.com/watch?v=153fkBow-Ec>

<http://top-channel.tv/video/mbyllen-guroret-e-krujes/>

<https://konica.al/2018/11/pasojat-shkaterriktare-pritet-mbyllja-e-guroreve-te-krujes/>

<http://www.tematv.al/node/58430>

## Njoftim për Shtyp / nga Qendra EDEN

### Njoftim për shtyp

17 Tetor 2018 (10:01)

Attn: Redaktorët e Mjedisit, Politikës, Shëndetësisë  
 Kontakte: Jonida Mamaj-Hafizi, Qendra EDEN,  
[jonida.mamaj@eden-al.org](mailto:jonida.mamaj@eden-al.org)

Studimi Evropian tregon kimikatet toksike të mbetjeve elektronike që përmbajnë produktet e fëmijëve përmes riciklimit / Kimikati Brominated Falme Retanders (BRFs) i ndaluar u gjet gjithashtu në Shqipëri në lodra dhe në aksesoret e flokëve. [Këtu do të gjeni dhe raportin e studimit!](#)

Tiranë - Kërkesit e shëndetit mjedisor kanë nxjerrë të dhëna alarmuese sot se BFRs (Rominated Falme Retanders), kimikat i rrezikshëm nga mbetjet elektronike, i cili është i njohur për ndërprerjen e funksioneve të tiroides dhe gjithashtu shkakton mungesë (deficit) neurologjik dhe vëmendje tek fëmijët, po kontaminon plastikën e ricikluar në produktet e konsumit në të gjithë Evropën.

Studimi, analizë e 109 lodrave, aksesoreve të flokëve dhe enëve të kuzhinës, tregoi se 107 artikuj (98%) përmbajnë përqëndrime të matshme të difenileve polybrominated diphenyl ethers (PBDEs) dhe 80 mostra (73%) përmbanin hexabromocyclododecane (HBCD).

Nga produktet e bëra në Shqipëri, analiza laboratorike nga 4 mostra të aksesoreve të flokëve gjeti 3 mostra që përmbanin OctaBDE në përqëndrime që varionin nga 2 në 57 ppm dhe DecaBDE në përqëndrime që varionin nga 34 në 1048 ppm. Në përgjithësi, rezultatet tregojnë se kimikatet toksike retardante të flakës që gjenden në mbetjet elektronike janë të pranishme në tregun shqiptar në produktet e konsumit të prodhuara nga plastika e ricikluar. Kjo përfshin substancat e listuara në Konventën e Stokholmit për eliminimin global

(OctaBDE dhe DecaBDE). Në fund të jetës së këtyre produkteve, do të zbatohet kufiri i përkohshëm i mbetjeve të NOQ-v (Ndotës Oragnik të Qendrueshëm). Limiti i mbeturinave aktualisht përcaktohet nga Konventa e Stokholmit si 50 ppm ose 1000 ppm. Nëse kufiri aplikohet në nivelin mbrojtës prej 50 ppm, një produkt do të binte në klasën e mbetjeve të NOQ-ve për shkak të përqendrimit OctaBDE prej 57 ppm.

*"Plastikat toksike që përmbajnë BFRs në nivele mbi 50 ppm duhet të konsiderohen mbetje të rrezikshme", tha Jindrich Petrlik, Drejtor Ekzekutiv i Programit Toksik dhe Mbetjeve, Arnika dhe bashkë-drejtuari i grupit të punës për dioksinën, PBC dhe mbetjeve të IPEN. "Vetëm një kufizim i rreptë i mbetjeve të rrezikshme mund të mbyllë shtegun toksik pasi do të kërkonte që plastikat toksike të hiqen nga rryma e riciklimit të mbetjeve".*

Diezilet e polibromatizuara (PBDEs) dhe (HBCDs) janë retardantë toksikë të zjarrit që janë ndër 28 kimikatet më të rrezikshme në botë për shkak të qendresës së tyre në mjedis. PBDEs u gjetën në tubat dhe telat izolues të sendeve elektronike të vjetra dhe HBCD u shfaq në shkume polistiren dhe në plastikën e cila përdoret për sendet elektronike dhe për makinat. Jitka Strakova, hulumtuese e specializuar e NOQ-ve nga Arnika dhe autore kryesore e studimit: "Sistemi endokrin i një fëmije nuk do tja dijë nëse një lodër është bërë nga plastika e re apo e ricikluar kur funksioni i tij u ndërpritet nga kimikati toksik PBDE. E vetmja mënyrë për të mbrojtur njerëzit nga kimikatet e rrezikshme në mbetjet e ricikluara është mbyllja e këtij cikli riciklues distancimi e mbeturinave të rrezikshme nga riciklimi plastikës".

Duke theksuar se përjashtimet e riciklimit për PBDEs janë një standard i dyfishtë për *Vijon në faqe 8*

Kampioni	Kampioni	ID Kampionit	Bromine	Antimony	octaBDE	decaBDE	ΣPBDEs	HBCD	ΣnBFRs
Flokë	Kapse	AL-H-1A	1 95	820	2	34	36	<LOQ	13
Flokë	Kapse	AL-H-1F	5 877	2 307	37	396	433	0	48
Flokë	Kapse	AL-H-1J	6 340	2 272	57	1 048	1 105	0	112
Flokë	Kapse	AL-H-1L	1 319	366	<LOQ	<LOQ	<LOQ	<LOQ	<LOQ

Vijon nga faqe 7 plastikën, hulmtuesit, advokuesit e shëndetit publik dhe OJQ-të, duke përfshirë Qendrën Mjedisore EDEN i bën thirrje shtetit Shqiptar të luaj rolin e saj për të siguruar që Bashkimi Evropian (BE) të kërkojë që plastika e ricikluar të përmbushë të njëjtin standard si plastika e re.

"Toxic Loophole: Riciklimi i mbetjeve të rrezikshme në produkte të reja" është kryer nga Arnika, HEAL dhe IPEN. 430 mostra janë mbledhur në vendet në vijim: Shtetet Anëtare të Bashkimit Evropian (Austria,

Belgjika, Çekia, Danimarka, Franca, Gjermania, Holanda, Polonia, Portugalia, Spanja dhe Suedia) dhe vendet përreth Evropës Qendrore dhe Lindore (Shqipëria, Armenia, Bjellorusia, Bosnja dhe Hercegovina, Maqedonia, Mali i Zi, Rusia dhe Serbia) nga periudha prill deri në korrik 2018. Më pas, 109 produkte u analizuan për përqëndrimet e kimikateve specifike të BFRs nga laboratorit i Universitetit të Kimisë dhe Teknologjisë në Pragë.

## Trainime për OSHC-të nga rajoni / nga Qendra EDEN

Një trajnim tre-ditor për organizatat e shoqërisë civile nga Shqipëria dhe Maqedonia mbi Advokim dhe Lobim u zhvillua në Tiranë, më 21-23 Nëntor 2018. Trajnimi mbledhi rreth 30 OSHC të cilat patën mundësinë të përmirësonin njohuritë dhe aftësitë e tyre në konceptin e avokimit publik dhe lobimit si një mjet për arritjen e zhvillimit të qëndrueshëm.

Rezultatet e pritshme nga ky trajnim:

- Përmirësimi i njohurive dhe aftësive të OShC-ve në konceptin e avokimit publik dhe lobimit si një mjet për arritjen e zhvillimit të qëndrueshëm
- Komunikimi në mënyrë efektive mbi diskutimet publike për çështjet thelbësore
- Ndërtimi dhe mirëmbajtja e partneriteteve
- Zhvillimi dhe Plani i Veprimit për Avokim duke u fokusuar në ekonominë e gjelbër dhe sipërmarrjen e gjelbër.

Veprimtaria kombinoi leksione, punë grupore, ushtrime skenari dhe praktika aftësie. I gjithë trajnimi ndoqi një qasje interaktive ku pjesëmarrësve iu kërkua kontribut dhe reflektim.

Trajnimi ishte pjesë e projektit "GEAR - Ekonomia e Gjelbër për një Zhvillim Rajonal", që ka si qëllim rritjen e aktiviteteve dhe ndikimit të organizatave të shoqërisë civile nga Shqipëria, Mali i Zi, Serbia, Bosnja dhe Hercegovina dhe Maqedonia, në mbrojtje të

mjedisit përmes rrjeteve, duke forcuar kapacitetet e tyre dhe duke promovuar ekonominë e gjelbër. Mbështetet financiarisht nga Bashkimi Evropian! Projekti realizohet në partneritet me organizatën FORS Mal i Zi i cili është dhe koordinatori i projektit, Qendra EDEN nga Shqipëria, SMART Kolektiv nga Serbia, Qendra për përkrahje dhe zhvillim nga BiH, EKO Svest nga Maqedonia dhe Shoqata Slap nga Kroacia.



Përveç trajnimeve, projekti përfshin një sërë aktiviteteve që synojnë përmirësimin e mtejshëm të kapaciteteve dhe ndikimeve të OShC-ve në mbrojtjen e mjedisit dhe promovimin e ekonomisë së gjelbër, si: familjarizimi me

modelet e praktikave të mira në ekonominë e gjelbër dhe sipërmarrjen e gjelbër përmes vizitave studimore në BE dhe prezantimet e organizuara në vendet e synuara, subgrantime për organizatat e shoqërisë civile, konferencat rajonale për ekonominë e gjelbër dhe sipërmarrjen e gjelbër, zhvillimin e një Studimi mbi mundësitë për zhvillimin e ekonomisë së gjelbër në rajonin e synuar.

Për më shumë informacion mbi projektin mund të kontaktoni Albana Joxhe,  
email: [albana.bregaj@eden-al.org](mailto:albana.bregaj@eden-al.org),  
Qendra EDEN. Na ndiqni në faqen tonë në [facebook](#)



## Shoqëri pjesëmarrëse në vendimmarrje / nga Qendra EDEN

*vendimmarrje*: E drejta për të marrë vendim. Roli i shoqërisë civile në vijimësi është plotësuar nga kuadri ligjor për të rritur ndikimin në procesin vendimmarrës në sektorin e mjedisit. Kuadri ligjor në këtë pjesë plotësohet si me ligjin "Për të drejtën e informimit" (<https://bit.ly/2SQfyXZ>) apo në lidhje me procesin e Vlerësimit të Ndikimit në Mjedis me VKM "Për përcaktimin e rregullave, të kërkesave e të procedurave për informimin dhe përfshirjen e publikut në vendimmarrjen mjedisore" <https://goo.gl/5KpK5p>. Qendra mjedisore EDEN së bashku me 4 organizatat partnere zbatuese të projektit "Shoqëri pjesëmarrëse në vendimmarrje" <https://goo.gl/sCKiL8> kanë ndjekur në mënyrë intensive në 5 qyteve të Shqipërisë 20 dëgjesa me publikun gjatë periudhës mars 2017-shtator 2018 (7 dëgjesa për raportet e Vlerësimit të Ndikimit në Mjedis, 7 dëgjesa për leje mjedisore dhe 6 dëgjesa për Vlerësim Strategjik në Mjedis). Vlerësohet mbi të gjitha përpjekjet për të kushtuar rëndësi konsultës së publikut sipas kuadrit ligjor, por procesi ka mjaft mangësi si në mënyrën e



njoftimit, në zhvillimin e dëgjesës dhe në përmbajtjen e vetë dëgjesës së zhvilluar. Në mënyrë që procesi të jetë sa më cilësor dhe të forcohet zbatimit i kuadrit ligjor përkatës, gjatë pjesëmarrjes në dëgjesa të organizatave janë vërejtur momente delikate për të cilat nevojitet një ndërhyrje e shpejtë është e nevojshme.

**Mënyra e njoftimit:** forma elektronike nuk mund të vlerësohet si një nga mënyrat kryesore të njoftimit, duhet të përdoren të gjitha mënyrat e tjera për të arritur publikun; faqet e Drejtorive Rajonale të Mjedisit (DRM) duhet të përmbajnë të gjithë informacionin e saktë për dëgjesën me publikun për vendin e saktë të zhvillimit të dëgjesës dhe dokumentacioni shoqëruar për dëgjesën të shkarkohet

nga faqia e DRM-së

**Zhvillimi dhe cilësia e dëgjesës:** Raportet e VNM-së duhet të rrisin cilësinë e përmbajtjes së tyre si në shkrim apo në çështjet që duhet të trajtohen në brendësi të raportit. Gjuha e përdorur dhe në raportet jo teknike duhet të jetë edhe me e thjeshtë për tu kuptuar nga publiku. Për të lexuar drejtë një raport VNM-je vjen në ndihmë "Listë kontrolli për shqyrtimin e studimeve të vlerësimit të ndikimit mjedisor" <https://goo.gl/JyBZZi> e hartuar në kuadër të projekti CO-SEED. Faqia e AKM-së duhet të bëjë transparent procesverbalet e mbajtura nga DRM-të dhe gjithashtu të bëjë transparente dhe argumentet për mos marrjen parasysh të komenteve të dërguara për raportet e konsultuara.

Këto janë disa nga çështjet delikate të ngritura të cilat i janë adresuar në datë 31/10/2018 Agjencisë Kombëtare të Mjedisit me anë të një letre.

Për më shumë mund të lexoni: "Përmbledhje e rasteve të ndjekura në kuadër të zbatimit të projektit dhe letren drejtuar Agjencisë Kombëtare të Mjedisit"

<https://bit.ly/2Qljwpr> dhe kronikën "Të heshturit e publikut" <https://bit.ly/2SSe3bI>.

Projekti "Shoqëri pjesëmarrëse në vendimmarrje" nëntor 2016- tetor 2018 është zbatuar në Shqipëri, nga Qendra mjedisore për Zhvillim, Edukim dhe Rrjetëzim (EDEN) në Tiranë; Klubi Ekologjik Elbasan (KEE) në Elbasan; Për Mirëqenie Sociale dhe Mjedisore (PMSM) në Berat; Qendra e Informacionit Aarhus Shkodër (AIC) në Shkodër; Qendra për Kërkim, Bashkëpunim dhe Zhvillim (CRCD) në Vlorë. Projekti është mundësuar nga projekti "Shoqëria Civile Vepron për Zhvillimin Social-Ekonomik mbi Bazat e një Mjedisit të Shëndetshëm" (CO-SEED) <http://co-seed.eu/> me fonde të Bashkimit Evropian dhe që zbatohet nga INCA <http://www.inca-al.org/sq/>.

## Si e përmirëson pjesëmarrja publike vendimmarrjen për çështjet mjedisore?



*Fragmente nga manuali i praktikave më të mira botërore*

Shteti: **Sri Lanka**

Rasti: Banorët kundër marrëveshjes së investimit minerar.

*Theksi: Jo gjithmonë koncesionet (përfitimet ekonomike) janë më të rëndësishme se mirëqenia e vendasve.*

Përfaqësuesit e qeverisë së Sri Lankës dhe një kompanie amerikane kishin arritur në të ashtuquajturën "Marrëveshjen e Investimeve Minerare" për grumbullimin e shkëmbinjve fosfatikë në zonën e Anuradhapura-s. Një grup studiuesish, që ishin banorë të zonës përkatëse dhe të angazhuar me kultivimin e tokës, shfaqën ankesa se marrëveshja e investimit shkelte të drejtat e tyre sipas Kushtetutës. Studiuesit individualë kishin statusin ligjor të kërkonin respektimin e të drejtave të tyre sipas Kushtetutës. Gjykata interesohej për të drejtat e studiuesve individualë, të cilat kishin lidhje me të drejtat e

përbashkëta të të gjithë qytetarëve të Sri Lankës. Ajo nënvizoi faktin që shkalla e gërmimeve do të rritej aq sa do të shteronte të gjitha rezervat e fosfatit. Meqenëse fosfati është burim i papërtëritshëm, një skemë e tillë eksplorimi nuk do t'iu sillte përfitime brezave të ardhshëm. Në bazë të normave ndërkombëtare, burimet natyrore duhen ruajtur në mënyrë që të përmbushin nevojat e brezave të ardhshëm.

Lidhur me çështjen *Eppawela*, Gjykata e Lartë në Sri Lanka vendosi që propozimi i qeverisë për t'i lëshuar me qira minierën e fosfatit një kompanie private për 30 vjet binte ndesh me parimet e zhvillimit të qëndrueshëm, si dhe nuk i ishte nënshtruar një vlerësimi të përshtatshëm mjedisor. Për të nënvizuar rëndësinë e aksesit publik në informacione për mjedisin, dhe gjykatë, ajo përdori politikën e Komisionit Evropian dhe Deklaratën e Rios, që janë në përputhje me të drejtat themelore që siguron Kushtetuta e Sri Lankës.

### ...me këtë rast Ju kujtojmë se 23 vjet më parë...

...me Urdhër të Ministrisë së Bujqësisë nr.2, dt. 26.12.1995, territori lagunor, pyjet aluvional dhe pjesë e dunave ranore të Rrushkullit-Rrotull, me sipërfaqe 650 ha, ri shpallet Rezervat Gjuetie, i shpallur për herë të parë në dt. 07.07.1956, me sipërfaqe 1286 ha. Me udhër nr.404, dt. 25.01.1983, sipërfaqja e rezervatit të Rrushkull-Rrotull zvogëlohet në 700 ha, duke hequr sipërfaqen e Rrotullës.

Pas miratimit të ligjit për Zonat e Mbrojtura ky rezervat u njehësuar me statusin, sipas IUCN, "Rezervat Natyror i Menaxhuar". Gjendja është tepër e rënduar, përshkak se ky territor është dhënë për mbarështimin e faunës së egër. Në fakt aty rriten në

kushte jo normale edhe kafshë e shpendë që nuk i takojnë këtij rezervati, pra ka humbur funksionet dhe statusin e ZM të Menaxhuar...

### ...16 vjet më parë ...

...me VKM nr.676, dt. 20.12.2002, shpallen "ZONË E MBROJTUR" 750 njësi Bio dhe Gjeo Monumente të Natyrës Shqiptare...

### ...10 vjet më parë ...

...me VKM nr.1631, dt. 17.12.2008, ekosistemi natyror-malor i Bredhit të Hotovës-Dangëlli, me sipërfaqe 34,361.1ha, shpallet Park Kombëtar me sipërfaqe të zgjeruar, pasi në të u përfshi dhe territori, kryesisht bredhishtja, me sipërfaqe prej 4200 ha i "Bredhit të Hotovës", i shpallur park kombëtar, me VKM nr. 102, datë 15.01.1996. Për këtë park kombëtar, me mbështetje të IPA10, nëpërmjet projektit SELEA, është hartuar dhe Plani i Menaxhimit, i cili deri më sot nuk ka gjetur zbatim. Me shqetësuese për menexhimin e parkut është ndërtimi i HEC-ve, veçanërisht ai mbi lumin e Langaricës, i cili cënon rëndë kanionin dhe ujërat termale të Bënjës...

### ...7 vjet më parë ...

...me VKM nr.898, dt. 21.12.2011, ekosistemi natyror-malor i Korab-Koritnikut, me sipërfaqe 55,550.2 ha, të shtrinë në qarkun e Dibrës dhe të Kukësit, shpallet "Park Natyror". Me mbështetje të IPA10, nëpërmjet projektit SELEA, është hartuar dhe Plani i Menaxhimit, i cili deri më sot nuk ka gjetur zbatim. Me shqetësuese për menexhimin e parkut është ndërtimi i HEC-ve, veçanërisht mbi lumin e Lumës dhe të Radomirës.

## NJOFTIME

### 5 Dhjetor - Dita Botërore e Tokës

Dita Ndërkombëtare e Vullnetarizimit

### 11 Dhjetor - Dita Ndërkombëtare e Maleve

1 - Për të lexuar "Ditari i Natyrës" në vite...

<http://www.inca-al.org/index.php/sq/publikimet/ditari-i-natyres>

## Udhëzime për të kontribuar në Ditarin e Natyrës

Instituti për Ruajtjen e Natyrës në Shqipëri mirëpret artikuj të ndryshëm të cilët ju dëshironi t'i publikoni në Ditarin e tij elektronik. Artikujt duhet të jenë jo më shumë se 200 - 250 fjalë. Ju lutemi të merrni në konsideratë këtë kërkesë, pasi interesi për të shpërndarë artikuj, lajme apo njoftime të ndryshme përmes Ditarit, mund të jetë i konsiderueshëm dhe ne do të përpiqemi për të siguruar hapësirë për të gjithë ju që dëshironi të kontribuoni. Redaksia ruan të drejtën për të shkurtuar apo modifikuar (jo tjetërsuar) tekstin nëse do të jetë e nevojshme.

Ju lutemi dërgoni një foto shoqëruese për artikullin tuaj dhe / ose web - link për referencë të mëtejshme.

Faleminderit për marrjen në konsideratë të këtyre udhëzimeve!

### Grupimi "Të Shpëtojme Arinjtë Shqiptarë"



### Organizatat Partnere të Rrjetit për Mbrojtjen e Natyrës



Botim i Institutit për Ruajtjen e Natyrës në Shqipëri / INCA  
Redaksia: Nihat Dragoti; Ilirjan Qirjazi; Vilma Kadiu; Marinela Mitro